



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

---

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tel: ++355 4 230434



# RAPORTI VJETOR

## 2009


## 1. HYRJJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2009 deri në 31 Dhjetor 2009.

Gjatë vitit kalendarik 2009 Agjencia e Prokurimit Publik e ka ushtruar veprimtarinë e saj në bazë të ligjit **Nr.9643, datë 20.11.2006** “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.84, datë 10.05.2007 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Konkretisht struktura e APP-së është si më poshtë:

### STRUKTURA E AGJENCISE SE PROKURIMIT PUBLIK



## **2. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA**

Në ushtrimin e aktivitetit të saj gjatë vitit 2009, APP-ja nuk është asistuar nga ndonjë projekt i huaj. Gjatë këtij viti APP-ja në bashkëpunim me Delegacionin e Komisionit Evropian në Shqipëri përfundoi procesin e përzgjedhjes së fituesve të projektit të binjakëzimit “Mbështetje për forcimin e sistemit të prokurimit publik, konçesioneve dhe ankandeve në Shqipëri”, të financuar nga fondet e IPA-s 2008. Në përfundim të procesit të tenderimit, si fitues u përzgjodh një bashkëpunim Polako-Rumun që përfaqësohet nga Zyra e Prokurimeve Publike në Poloni dhe Autoriteti për Rregullimin dhe Monitorimin e Prokurimit Publik në Rumani. Ky projekt pritet të fillojë në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2010.

Projekti i binjakëzimit do të konsistojë në 3 drejtime kryesore:

- I. Reforma institucionale dhe ligjore;
- II. Ngritja e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit, koncesionit dhe ankandit publik.
- III. Rritja e ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore, të biznesit dhe publikut të gjerë rreth sistemit të prokurimit, koncesionit dhe ankandit publik.

## **3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2009**

### **3.1. Ndryshimet legislative**

Në këtë drejtim ndryshimet kryesore gjatë vitit 2009 kanë konsistuar kryesisht në përshtatjen e bazës ligjore me iniciativën e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik në

## **Raporti Vjetor\_2009**

masën 100%. Në këtë kuadër në Janar të vitit 2009, u miratua nga Këshilli i Ministrave Vendimi nr. 45, datë 21.01.2009, i cili sanksiononte se të gjitha procedurat e prokurimit publik do të zhvillohen në formë elektronike. Po në këtë periudhë me qëllim përmirësimin e legjislacionit dytësor, dhe rregullimet ligjore të përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik, Agjencia e Prokurimit Publik përgatiti disa amendime në rregullat e prokurimit publik të cilat Këshilli i Ministrave i miratoi me vendimin nr.46, datë 21.01.2009. Në vijimësi të këtyre ndryshimeve, APP-ja përgatiti dhe miratoi në datë 04.02.2009 Dokumentet Standard të Tenderit ku pasqyroheshin ndryshimet përkatëse të bëra në rregullat e prokurimit publik.

Në muajin Janar 2009, për t'u ardhur sa më shumë në ndihmë palëve të përfshira në procesin e prokurimit publik (autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë), hartoi një Udhëzim të detajuar “Për procedurat e prokurimit me mjete elektronike”.

Në muajin Maj 2009, APP-ja hartoi dhe paraqiti në Këshillin e Ministrave disa ndryshime në VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, të cilat u miratuan me VKM nr. 495, datë 15.05.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Gjithashtu në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.53, datë 21.01.2009 “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, APP hartoi dhe miratoi Udhëzimin nr. 1, datë 06.02.2008 “Për procedurat e prokurimit publik, për disa mallra dhe shërbime në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe institucioneve të varësisë nga organi qendror blerës, Ministria e Brendshme”.

## **Raporti Vjetor\_2009**

Në kuadër të procesit të Integritimit Evropian dhe detyrimeve në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në fushën e prokurimit publik, përkatësisht Nenet 70 dhe 74 si dhe Marrëveshjen e Ndërmjetme, Neni 40, gjatë vitit 2009, një vëmendje e veçantë i është kushtuar ndërmarrjes së iniciativave ligjore dhe forcimit të kapaciteteve, si prioritete të Dokumentit të Partneritetit Evropian dhe Progres Raportit të Komisionit Evropian të vitit 2008, për Shqipërinë, si prioritet kryesor përmendet përafrimi i mëtejshëm në fushën e prokurimit, veçanërisht në utilitete.

Në këtë kuadër, edhe gjatë vitit 2009, Agjencia e Prokurimit Publik, në bashkëpunim me SIGMA-n (Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Administrim), vijoi punën për përgatitjen e projektligjit “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Projektligji “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, konsiston në dy drejtime kryesore; sistemin e rishikimit në prokurime dhe prezantimin në ligj të një Kapitulli krejtësisht të ri, që trajton procedurat e prokurimit për kontrata publike të akorduara nga Autoritetet Kontraktore që operojnë në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe atij postar. Ky kapitull u hartua në përputhje me Direktivën e BE-së 2004/17 “Mbi koordinimin e procedurave të prokurimit për operatorët që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare”.

Projektligji në fjalë iu propozua nga APP-ja Këshillit të Ministrave në muajin Korrik 2009, dhe pasi u miratua në Këshillin e Ministrave, iu dërgua për aprovim Kuvendit të Shqipërisë.

Në muajin Tetor 2010, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, disa ndryshime në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i

## **Raporti Vjetor\_2009**

ndryshuar, me të cilin krijohet një institucion i pavarur rishikimi për ankesat e operatorëve ekonomikë, si dhe gjithashtu parashikohen në mënyrë të detajuar marrëveshja kuadër dhe sektorët utilitarë (ujë, energji, transport dhe shërbimet postare). Institucioni i pavarur i rishikimit të ankesave do të jetë Komisioni i Prokurimit Publik, i cili sipas ligjit është një organ kolegial në varësinë e Këshillit të Ministrave. Ndryshimet e fundit në ligj parashikojnë një përkufizim më të plotë të marrëveshjes kuadër, e cila mund të përdoret për të gjitha llojet e kontratave (mallra, shërbime dhe punë). Për herë të parë në legjislacionin shqiptar të prokurimit publik parashikohet një kapitull i veçantë për prokurimin në sektorët utilitarë, i cili është në përputhje me Direktivën 2004/17/EC.

Ky është një hap i rëndësishëm në drejtim të përmbyshjes së detyrimeve të marra me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, në kuadër të procesit të integritimit evropian. Përmbyshja e këtyre detyrimeve dhe përmirësimi i sistemit të prokurimit publik, duke patur për qëllim mirë-zbatimin e legjislacionit të prokurimeve janë prioritetet afat shkurtra dhe afat mesme në këtë fushë.

## **4. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2009**

Për realizimin me sukses të detyrave ligjore, në funksion të mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, gjatë vitit 2009, APP-ja është përballur me sfida të ndryshme që kanë kërkuar angazhimin maksimal të saj, nga të cilat më kryesoret kanë qënë zbatimi i sistemit të prokurimit elektronik, për çdo procedurë prokurimi të zhvilluar nga të gjitha Autoritetet Kontraktore në Shqipëri, duke rritur kështu dhe nivelin e transparencës në procesin e prokurimit publik.

Platforma e prokurimit elektronik është një aplikim i bazuar në rrjet, që mbështet automatizimin e aktiviteteve të tenderimit të të gjitha Autoriteteve Kontraktore të Qeverisë së Shqipërisë. Ky sistem mundëson transaksione të sigurta ndërmjet institucioneve publike shqiptare dhe komunitetit kombëtar e ndërkombëtar të biznesit. Sistemi ofron përgatitje dhe administrim të sigurt, efikas e transparent të të gjithë dokumentave që lidhen me procesin e tenderimit, duke mënjanuar formën e dorëzimit të dokumentacionit në letër dhe duke siguruar një rrjedhë të sigurt të të dhënave përgjatë gjithë procesit. Dokumentacioni i tenderimit është i disponueshëm në sistemin e prokurimit elektronik (në adresën [e.ee.app.gov.al](http://e.ee.app.gov.al)), dhe të gjitha transaksionet që nga shkarkimi i dokumentave deri në ofertimin në mënyrë elektronike, është falas. Sistemi i prokurimit elektronik lejon mire menaxhimin e hapësirës që i dedikohet tenderit, redukton ndjeshëm kohën e aplikimit, eliminon dokumentacionin e panevojshëm, lehtëson dhe standardizon njohjen me kushtet e tenderit, garanton fshehtësinë e ofertes dhe në momentin e hapjes lejon publikimin e njekohshëm të ofertave, gjeneron raporte, si dhe ruajtjen elektronike të tyre për kontroll të mevonshme, duke pakesuar mundësinë e devijimeve korruptive.

Operatorët Ekonomikë shqiptarë që janë të regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve (QKR) mund të aplikojnë për t'u regjistruar edhe në SPE, në mënyrë që të kenë mundësi të ofertojnë në mënyrë elektronike në procedurat e prokurimit. Edhe operatorët ekonomikë të huaj për të përdorur sistemin e prokurimit elektronik, duhet të regjistrohen dhe të pajisen me një llogari përdoruesi. Kjo mund të realizohet duke u regjistruar On-line si Operator Ekonomik, ose në zyrën e APP-se.

Prokurimi publik përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit është më i lehtë, sepse procedurat janë më të shpejta dhe të thjeshtuara. Ai është më pak i kushtueshëm,

## **Raporti Vjetor\_2009**

sepse eliminimi i dokumenteve të tepërta shkresore dhe inkurajimi i konkurrencës, ul kostot. Sistemi siguron një pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve ekonomikë në tendera, duke qenë se ata mund t'i nisin ofertat e tyre në mënyrë elektronike nga ambjentet e tyre te punes pa qene e nevojshme qe te paraqiten prane Autoriteteve Kontraktore. Pra, konkurrenca rritet dhe si rrjedhojë sigurohen shërbime dhe mallra me cilësi më të mirë apo çmim më të ulët.

Duke marrë në konsideratë rezultatet e arritura nga zbatimi i pjesshëm i sistemit të prokurimit elektronik gjatë vitit 2008, i cili ishte një vit provë në këtë drejtim, si dhe njëkohësisht duke konsideruar qëllimin për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur në maksimum transparencën, siç u përmend dhe më sipër në muajin Janar 2009, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike”, sipas të cilit autoritetet kontraktore duhet të kryejnë të gjitha procedurat e tyre të prokurimit publik (përveç procedurës me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, dhe procedurës së prokurimit me vlera të vogla) me mjete elektronike.

Gjatë vitit 2009 të gjitha Autoritetet Kontraktore pa përjashtim, i zhvilluan të gjitha procedurat e prokurimit në formë elektronike. Asistenca e këtyre Autoriteteve Kontraktore për realizimin me sukses të procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike, ka qënë një sfidë shumë e madhe e APP-së, por megjithatë nga statistikat që rezultuan në fund të vitit 2009 (shiko kapitullin përkatës), vërehet se rezultatet e kërkuara, janë arritur.

Mënyra e prokurimit me anë të sistemit elektronik, mund të realizohet vetëm me kontributin aktiv si të Autoritetit Kontraktor, ashtu dhe atë të operatorëve ekonomikë që janë të interesuar të marrin pjesë në një procedurë prokurimi të caktuar. Për këtë arsye, njohja e sistemit të prokurimit elektronik nga të dyja palët është një kërkesë e domosdoshme



për të bërë të mundur realizimin e procedurave të prokurimit publik. Dhe kjo ka qënë një tjetër sfidë e APP-së gjatë vitit 2009, ngritja e kapaciteteve të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë. Këtë detyrë Agjencia e Prokurimeve Publike, e ka realizuar duke impenjuar maksimalisht stafin e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit si dhe pjesën tjetër të stafit teknik, duke ofruar trajnime të vazhdueshme dhe asistencë për legjislacionin e prokurimeve publike dhe në zbatimin e sistemit të prokurimit elektronik në vend.

Gjithashtu një tjetër sfidë me të cilën është përballur Agjencia e Prokurimit Publik gjatë këtij viti, në kuadër të respektimit të parimit të transparencës, ka qënë botimi elektronikisht në faqen e internetit të APP-së, i të gjithë informacionit që ka të bëjë me një procedurë prokurimi duke filluar me dokumentet e tenderit dhe më tej të gjitha njoftimet që kanë lidhje me ecurinë e një procedure prokurimi nga njoftimi i kontratës deri në botimin e njoftimit për kontratën e nënshkruar. Rezultatet e marra në fund të vitit (referuar analizës së punës së Sektorit të IT, ku pasqyrohet numri i përdoruesve të sistemit gjatë vitit 2009, numri mesatar i përdoruesve për ditë etj), tregojnë se APP-ja dhe këtë detyrë e ka realizuar me sukses, duke i dhënë mundësi çdo të interesuari në këtë fushë të marri informacionin që i nevojitet në kohë reale dhe pa pagesë.

## **5. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE.**

### **5.1. Bashkëpunimi i APP-së me institucione homologe të vendeve të rajonit dhe të BE-së**

Gjatë vitit 2009, Agjencia e Prokurimit Publik ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me institucione homologe ndërkombëtare. Në këtë kuadër përfaqësues nga Agjencia e

## **Raporti Vjetor\_2009**

Prokurimit Publik kanë marrë pjesë në disa takime ndërkombëtare, kanë zhvilluar vizita në disa nga vendet e rajonit dhe të BE-së si dhe kanë pritur delegacione me përfaqësues të këtyre vendeve.

Një bashkëpunim shumë të rëndësishëm gjatë këtij viti APP-ja ka pasur me Delegacionin e Komisionit Evropian në Shqipëri. Ky bashkëpunim ka konsistuar në drejtime të ndryshme në fushën e prokurimit, ku një nga drejtimet më kryesore ka qënë puna e përbashkët për hartimin e termave të referencës (project fiche) dhe përzgjedhjen e fituesit të projektit të inçing që APP ka fituar nga fondet e IPA-s 2008.

Një bashkëpunim tjetër shumë të rëndësishëm gjatë vitit 2009, APP e ka pasur me SIGMA-n (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qendrore dhe Lindore), një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, financuar nga BE, me përfaqësues të të cilës ka punuar intensivisht për hartimin e mendimeve të ligjit të prokurimit publik. Kontributi i SIGMA-s ka qënë shumë i rëndësishëm në hartimin e këtyre ndryshimeve në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së.

Në muajin Shkurt 2009, dy përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik, zhvilluan një takim një ditor në Prishtinë, Kosovë me përfaqësues të institucioneve homologe atje. Në takim u ndanë eksperiencat përkatëse në fushat e kontratave publike.

Në muajt Shtator-Tetor 2009, APP-ja ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë dhe me SIGMA-n (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qendrore dhe Lindore), një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, financuar nga BE, për diskutimin e moduleve të trajnimit në fushën e prokurimit publik, që do të organizohet në të gjithë vendet e Ballkanit nga një projekt i fituar nga fondet e IPA-s. Përfaqësues të APP-së që

kanë marrë pjesë në këto takime, kanë dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm në hartimin e moduleve të trajnimit të sipërpërmendur.

Në muajin Tetor 2009, dy përfaqësues të APP-së morën pjesë në një takim të zhvilluar në Zagreb, Kroaci me përfaqësues nga vendet e Ballkanit ku u diskutua për mënyrat më efikase të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve në fushën e prokurimit publik. Në këtë takim, përfaqësuesit e APP-së prezantuan eksperiencën e Shqipërisë në këtë drejtim.

Në muajin Nëntor 2009 përfaqësues të APP-së morën pjesë në një tryezë të rrumbullakët të zhvilluar në Lubjanë, Slloveni ku u diskutua për detyrimet e marra në marrëveshjen e CEFTA-s, për sa i përket prokurimit publik.

## **5.2. Bashkëpunimi i APP-së me institucione të tjera në Shqipëri**

Gjatë vitit 2009 Agjencia e Prokurimit Publik ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me institucione të pushtetit qendror dhe vendor brenda vendit. Një bashkëpunim të ngushtë dhe intensiv, APP-ja ka vazhduar të ketë dhe gjatë vitit 2009, me Ministrinë e Integritit. Në mënyrë periodike, në Ministrinë e Integritit është raportuar progresi që ka bërë APP-ja në drejtim të zbatimit të angazhimeve që janë marrë me nënshkrimin e MSA-së në fushën e prokurimeve publike. Me këtë Ministri janë realizuar takime të shpeshta që kanë pasur si objektiv konsultimin e specialistëve me qëllim realizimin e objektivave në fushën e integritit. Bashkëpunimi me këtë Ministri është intensifikuar në 3-mujorin e fundit të vitit 2009, kur filloi puna për përgatitjen e Pyetësorit të dërguar nga Bashkimi Evropian. Duke qënë se në këtë Pyetësor, kishte një kapitull të vecantë për prokurimin publik, angazhimi i APP-së dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Integritit gjatë kësaj periudhe ka qënë në nivele maksimale.

Një institucion tjetër me të cilin APP ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë ka qënë dhe Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Pasurive, me të cilin në Muajin Shkurt 2009, përgatiti një formular për deklarimin e interesave nga ana e operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në procedura prokurimi. Pasur në konsideratë rëndësinë e këtij deklarimi, formulari u bë pjesë e Dokumenteve Standardë të Tenderit. Bashkëpunimi me këtë institucion ka vijuar më tej me hartimin e një Manuali 'Për konfliktin e interesave në prokurimet publike', ku roli i këtyre dy institucioneve ka qënë thelbësor.

### **5.2.1. Bashkëpunimi me Avokatin e Prokurimeve**

Gjatë vitit 2009, Agjencia e Prokurimit Publik, në ushtrimin e detyrave të saj ligjore, ka pasur bashkëpunim dhe me institucionin e Avokatit të Prokurimeve.

Aktivitetet e këtyre dy institucioneve janë "takuar" kryesisht në shqyrtimin administrativ të ankesave. Meqënëse APP-ja ka qënë institucioni që ka pasur të drejtën ligjore për të marrë një vendim përfundimtar në shkallë administrative, si dhe nisur nga fakti që ankimet në APP mund të bëhen vetëm brenda një afati të caktuar, në përgjithësi ankesat e operatorëve ekonomikë, janë marrë në shqyrtim më parë nga APP-ja se sa nga Avokati i Prokurimeve. Megjithatë rekomandimet e dhëna nga Avokati i Prokurimeve, edhe pse kanë dalë mbas vendimeve të APP-së, në masën 80%, përputhen, me këto të fundit.

Gjithsesi, duke vlerësuar frymën e bashkëpunimit, theksojmë se disa nga rekomandimet e dhëna nga Avokati i Prokurimeve, gjatë vitit 2009, tejkalojnë kompetencat e tij, si dhe në disa raste, këto rekomandime janë në tejkalim të kompetencave që ligji i jep APP-së. Një nga problemet e hasura gjatë këtij viti në lidhje me rekomandimet e Avokatit të Prokurimeve, ka qënë mënyra e shqyrtimit të ankesave. APP, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në dhënien e vendimeve të saj është bazuar kryesisht në shqyrtimin e ankesave të paraqitura, kurse

Avokati i Prokurimeve, me marrjen e ankesave kryen gjithmonë hetim administrativ të procedurës së prokurimit dhe një gjë të tillë ia rekomandon dhe APP-së.

Po kështu një rast tjetër kur rekomandimet e Av.P. tejkalojnë kompetencat e ligjit, është kur rekomandohet APP-ja të kryejë veprime dhe të marrë masa ndaj AK-ve për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e kontratës dhe jo më me zhvillimin e procedurës së prokurimit. Kështu psh në disa raste Av.P jep rekomandime, për procedura prokurimi, shumë kohë pasi ato janë kryer dhe ka filluar zbatimi i kontratës përkatëse, duke i bërë këto rekomandime të paaplikueshme si për APP-në ashtu edhe për AK-në përkatëse.

## **6. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË DREJTORIVE DHE SEKTORËVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK, GJATË VITIT 2009**

### **6.1. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË ANKESAVE DHE ASISTENCËS LIGJORE PËR PROKURIMET**

Gjatë vitit 2009, puna e Drejtorisë së Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Prokurimet është fokusuar në hartimin e legjislacionit të nevojshëm për realizimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike dhe në ndërmarrjen e iniciativave ligjore për përputhjen e legjislacionit të prokurimit publik me Direktivat e Bashkimit Evropian si pjesë e detyrimeve në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në fushën e prokurimit publik.

Për realizimin e këtyre sfidave Drejtoria e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Prokurimet e përqëndroi veprimtarinë e saj në tre drejtime kryesore:

#### **6.1.1. Ndryshimet legislative**

## **Raporti Vjetor\_2009**

Drejtoria e Ankesave dhe e Asistencës Ligjore për Prokurimet, gjatë vitit 2009, ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për hartimin e ndryshimeve legislative që janë bërë gjatë këtij viti. Në këtë kuadër, kjo drejtori gjatë vitit 2009 ka ndihmuar në përgatitjen e vendimeve dhe udhëzimeve si më poshtë:

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit me mjete elektronike”.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.46, datë 21.01.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.1, datë 10.01.2007, të Këshillit të Ministrave “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Dokumentet Standarte të Tenderit me ndryshimet përkatëse që pasqyronin ndryshimet e bëra në legjislacionin e prokurimeve.

Për t’u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, kjo drejtori në bashkëpunim me Sektorin e Teknologjisë së Informacionit hartuan edhe tre udhëzime: Udhëzimi “Për krijimin e dosjes së tenderit”; “Për paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë” dhe Për hapjen shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave me mjete elektronike”

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.53, datë 21.01.2009 “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për disa mallra dhe shërbime, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe institucioneve të varësisë”, APP hartoi dhe miratoi Udhëzimin nr. 1, datë 06.02.2009 “Për procedurat e prokurimit publik, për disa mallra dhe shërbime në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe institucioneve të varësisë nga organi qendror blerës, Ministria e Brendshme”.

Gjithashtu gjatë vitit 2009 kjo drejtori është përfshirë maksimalisht në hartimin e projekt ligjit për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i

## **Raporti Vjetor\_2009**

ndryshuar. Këto ndryshime u bënë në dy drejtime kryesore dhe konkretisht: prokurimet publike në sektorët utilitarë dhe sistemi i rishikimeve në fushën e prokurimit. Sic është përmendur dhe më sipër në këtë analizë, këto ndryshime u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.10170, datë 22.10.2009 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 ”Për prokurimin publik””.

### **6.1.2. Praktikët e shqyrtuara për dhënie mendimesh, këshillash apo udhëzimesh**

Gjatë këtij viti, Drejtoria e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Prokurimet, në zbatim të detyrave që i ngarkon ligji nr.9643, datë 20.11.2006 „Për Prokurimin Publik“, i ndryshuar, ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë, duke konkluduar në vendimmarrjen përkatëse mbi procedurat konkrete të prokurimit që kanë konsistuar këto ankesa, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin nga prokurimet publike të shoqërive të ndryshme, etj.

Në muajt e parë të vitit 2009 (Janar, Shkurt, Mars, Prill), përgjithësisht, autoritetet kontraktore kanë kërkuar sqarime dhe udhëzime lidhur me formularët e rinj të DST, ndryshimeve në VKM dhe veçanërisht, për procedurën e prokurimit me mjete elektronike.

Asistenca e kësaj drejtorie është përqendruar kryesisht në mirëzbatimin e rregullave të prokurimit dhe këshillimin për problemet e ndeshura gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik.

## **Raporti Vjetor\_2009**

Gjatë muajit Tetor e deri në fund të vitit, kjo drejtori ka trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për sqarim dhe mendim nga autoritetet kontraktore, të cilat kanë konsistuar kryesisht në mënyrën se si duhet të procedohej për procedurat e prokurimit me fonde buxhetore, të nisura në këtë muaj, në kushtet kur, Rregullat e Prokurimit Publik përcaktojnë si afat perfundimtar (përfshirë edhe lidhjen e kontratave) datën 31 Tetor.

Konkretisht numri total i praktikave të paraqitura në këtë drejtori për mendim, sqarim apo udhëzime, gjatë vitit 2009 ka qënë 495.

Gjithashtu gjatë këtij viti kjo drejtori ka dhënë mendime dhe për projektvendime të ndryshme të iniciuara nga institucione të tjera, të cilat i janë përcjellë për mendim APP-së. Numri total i praktikave për të cilat kjo drejtori ka dhënë mendime për projektvendime të ndryshme, gjatë vitit 2009 ka qënë 29.

### **6.1.3. Shqyrtimi administrativ i ankesave**

Një nga funksionet kryesore të kësaj drejtorie dhe gjatë vitit 2009 ka qënë shqyrtimi administrativ i ankesave të operatorëve ekonomikë, të cilët, kanë interes apo ofertojnë në procedura prokurimi të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore.

Gjatë këtij viti shqyrtimi i ankesave u bë në mënyrë shkresore edhe pse procedurat e prokurimit u kryen me mjete elektronike.

Nga shqyrtimi i ankesave janë konstatuar disa probleme të cilat lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit nga autoritetet kontraktore gjatë përdorimit të SPE.

Gjatë vitit 2009, numri i ankesave në APP u rrit 2 herë më shumë krahasuar me një vit më parë. Shkaqet kryesore që kanë



ndikuar në këtë rritje kaq të madhe të numrit të ankesave kanë qënë:

- Rritja e numrit të ankesave për shkak të rritjes së numrit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si rezultat i përdorimit të SPE (mesatarja 7.7 operatorë ekonomik).
- Rritja e besimit tek transparenca e Sistemit të Prokurimit Elektronik, ku askush nuk mund të heqë dhe të shtojë dot dokumentat e tenderit.
- Një numër i madh ankesash, i cili zë rreth 50% të numrit total të ankesave, është bërë jo në përputhje me kërkesat ligjore për formën e ankimit (jo sipas formularit standard), respektimin e shkallëve të ankimit dhe/ose jashtë afatit ligjor, duke e rritur kështu në mënyrë artificiale numrin e ankesave.

**Konkretisht gjatë vitit 2009 janë paraqitur në total 1100 ankesa, nga të cilat:**

- **498 ankesa** kanë rezultuar **të pavlefshme**, për mosrespektim të shkallëve të ankimit, dhe/ose për paraqitje jo sipas formularit standard.

- **27 ankesa** kanë rezultuar **të pambështetura në ligj**.

- **për 67 ankesa** është marrë vendim për **modifikim** të dokumenteve të tenderit.

- **për 257 ankesa** është dhënë vendim për **anullim** procedure,

- **për 213 ankesa** është mbyllur hetimi administrativ dhe është **lejuar vazhdimi** i procedurës së prokurimit.

- **për 38 ankesa** është vendosur **rivleresimi** i procedurës së prokurimit.

## **Raporti Vjetor\_2009**

Në përfundim të hetimeve administrative, nga kjo drejtori janë vedosur gjoba si dhe janë propozuar masa ndaj personave përgjegjës në mbi **50%** të rasteve.


Nga hetimet administrative, për rastet në të cilat kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë lidhur kontratat, **për 28 raste** që i janë nënshtruar hetimit, kontratat kanë rezultuar absolutisht të pavlefshme.

Aktiviteti i Drejtorisë së Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Prokurimet, në mënyrë të përmbledhur në një tabelë, do të paraqitet si më poshtë:

### **Tabela Nr.1**

#### **Ecuria e ankesave për prokurimin publik gjatë vitit 2009**


Numri total i ankesave	Nr. i ankesave për të cilat është vendosur vazhdimi i procedurës	Nr. i ankesave për të cilat është vendosur anulimi	Nr. i ankesave për të cilat është vendosur rivlerësimi	Nr. i ankesave të pavlefshme, pa formular ankimi, modifikim DS
<b>1100</b>	<b>213</b>	<b>257</b>	<b>38</b>	<b>592</b>



Gjithashtu për të krijuar një ide më të qartë të ecurisë së numrit të ankesave në vite, më poshtë po paraqesim në formë tabelore dhe me grafikë, numrin e ankesave të shqyrtuara nga APP-ja sipas viteve 2007, 2008 dhe 2009.


### Numri i ankesave të paraqitura në APP gjatë vitit 2009

Numri total i ankesave për vitin 2009	Nr. i ankesave të paraqitura gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2009	Nr. i ankesave të paraqitura gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2009
<b>1100</b>	<b>534</b>	<b>566</b>




**Numri i ankesave të paraqitura në APP gjatë vitit 2008**

Numri total i ankesave për vitin 2008	Nr. i ankesave në gjyshtë mujorin e parë të vitit 2008	Nr. i ankesave në gjyshtë mujorin e dytë të vitit 2008
<b>564</b>	<b>237</b>	<b>327</b>




**Numri i ankesave të paraqitura në APP gjatë vitit 2007**

Numri total i ankesave për vitin 2007	Nr. i ankesave në gjashtë mujorin e parë të vitit 2007	Nr. i ankesave në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2007
<b>645</b>	<b>148</b>	<b>497</b>



Ashtu siç duket dhe nga numri i ankesave të paraqitura në tabelat e mësipërme respektivisht sipas viteve 2007, 2008 dhe 2009 shohim se numri i ankesave gjatë vitit 2009 është sa dyfishi i ankesave të paraqitura gjatë vitit paraardhës.



#### **6.1.4. Shqyrtimi i propozimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**

Një kompetencë tjetër ligjore e APP-së, që është ushtruar nëpërmjet kësaj drejtorie gjatë vitit 2009, ka qënë dhe marrja në shqyrtim e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi për një periudhë të caktuar kohore. Konkretisht gjatë vitit 2009 u morën në shqyrtim 16 propozime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, nga të cilat:

Në përfundim të procedimit administrativ:

- 8 operatorë ekonomikë janë përjashtuar nga e drejta për të marrë pjesë në prokurime;
- 6 operatorë ekonomikë nuk janë përjashtuar nga prokurimet publike pasi dokumentacioni i AK, për propozimet e tyre për përjashtimin nga prokurimet publike të këtyre shoqërive, është konsideruar i pamjaftueshëm;
- Për 2 operatorë ekonomikë procedimi administrativ për përjashtimin e tyre, ka filluar dhe është ende në proces.

#### **6.1.5. Bashkëpunimi me institucionin e Avokatit të Prokurimeve dhe Institucionet e tjera:**

Në respektim të dispozitave ligjore të prokurimit publik, kjo drejtori ka bashkëpunuar me Avokatin e Prokurimeve, gjatë punës hetimore për shqyrtimin e ankesave të ndryshme nga të dy palët. Korrespondenca me Avokatin e Prokurimeve dhe institucionet e tjera, gjatë vitit në fjalë ka qënë për 297 praktika.

Gjithashtu për këtë qëllim, është bashkëpunuar dhe me institucione të tjera, nga të cilat është kërkuar informacioni përkatës.

#### **6.1.6. Shqyrtimi i kërkesave për rishikim:**

Gjithashtu gjatë vitit 2009 në Drejtorinë e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Prokurimet, pas dhënies së vendimeve për procedura të ndryshme prokurimi, janë paraqitur 53 kërkesa për rishikim të vendimit të dhënë, për të cilat në 49 raste i është qëndruar vendimit dhe për 4 raste është vendosur revokim vendimi.

#### **6.1.7. Përfaqësimi i APP-së në çështjet gjyqësore**

Gjatë vitit 2009, kundër vendimeve të dala nga kjo drejtori ka pasur 7 akimime në gjykatë. Nga këto a) 2 çështje ishin për vendime të marrë në lidhje me procedura konkrete prokurimi, nga të cilat Gjykata për një ka lënë në fuqi vendimin e APP-së dhe për tjetrën ka marrë vendim për të rrëzuar vendimin e APP-së; b) 5 ankesa ishin kundër vendimeve të APP-së për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesmarrja në procedura prokurimi nga një deri në tre vjet. Këto vendime u rrëzuan nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe janë ankimuar nga APP-ja në Gjykatën e Apelit;

### **6.2. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË ANKESAVE DHE ASISTENCËS LIGJORE PËR KONÇESIONET**

Drejtoria e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Konçesionet, gjatë vitit 2009, ka punuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 'Për koncesionet', i ndryshuar, për mbikqyrjen e zbatimit të procedurave koncensionare. Kryesisht puna e kësaj drejtorie ka qenë e përqëndruar në shqyrtimin administrativ të ankesave të

operatorëve ekonomike. Gjithashtu gjatë këtij viti kjo drejtori ka bashkëpunuar edhe me institucionin e Avokatit të Prokurimeve, duke konsideruar edhe rekomandimet e tyre në marrjen e vendimeve përfundimtare të procedurave koncesionare, kur i ka gjetur ato të mbështetura në legjislacionin për koncesionet.

### **6.2.1 Shqyrtimi i ankesave koncesionare gjatë vitit 2009**

Drejtorja e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Koncesionet, bazuar në nenin 25 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2008 “Për koncesionet”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9643 datë 20.11.06 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.07 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve”, gjatë vitit 2009, ka shqyrtuar **30 ankesa** të operatorëve ekonomike, nga të cilat 29 ankesa janë për procedura koncesionare të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktues, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dhe një ankesë për një procedurë koncesionare të zhvilluar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Nga shqyrtimi i ankesave të sipërpermendura APP ka vendosur të mbyllë hetimin administrativ dhe të lejojë Autoritetin Kontraktues të vazhdojë procedurat e mëtejshme koncesionare për 16 procedura.

Drejtorja e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Koncesionet, në vijim të hetimit administrativ, duke qenë se ka konstatuar disa parregullesi nga ana e Autoritetit Kontraktues, për të gjykuar sa më drejtë dhe në mënyrë të paaneshme dhe transparente ka vendosur të dergojë për rivlerësim pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (METE) 4 procedura.

Gjithashtu në përfundimit të hetimit administrativ, duke qenë se ka konstatuar parregullsi në kryerjen e procedurave koncesionare, kjo drejtori ka vendosur të anullojë 4 procedura.



Gjatë shqyrtimit administrativ, të ankesave të dërguara në APP, ka rezultuar që operatorë të ndryshëm kanë depozituar edhe ankesa të paargumentuara juridikisht ose jashtë afateve dhe në këto raste, kjo drejtori nuk ka bërë pezullimin e procedurës konform nenit 25/4/a të ligjit të sipërpërmendur.

**Në mënyrë tabelore, numri i procedurave të shqyrtuara nga kjo drejtori gjatë vitit 2009, është si më poshtë:**

Procedura të shqyrtuara në total	<b>30</b>
Procedura të lejuara	16
Procedura të rivlerësuara	4
Procedura të anuluar	4
Ankesa te paargumentuara juridikisht	6

Gjithashtu, kjo drejtori në zbatim të ligjit Nr.9663, dt.18.12.2006 «Për Koncesionet» (i ndryshuar) dhe vendimit Nr.27, dt.19.01.2007 «Për Miratimin e Rregullave të Vlerësimit dhe Dhënies së Konçesioneve» (i ndryshuar), bazuar në raportimet periodike një herë në gjashtë muaj që dërgohen në Agjencinë e Prokurimit Publik (nëpërmjet regjistrave të konçesioneve), ka përgatitur raportin për Këshillin e Ministrave, me të dhënat kryesore mbi zbatimin e projekteve konçesionare, realizuar nga Autoriteti Kontraktues, METE.

**6.2.2. Përfaqësimi i APP-së në çështjet gjyqësore**

Gjatë vitit 2009, kundër vendimeve të dala nga kjo drejtori ka pasur 3 akimime në gjykatë të cilat ishin kundër vendimeve të APP-së për procedura koncesionare, nga të cilat për një çështje gjykata e shkallës së parë ka lënë në fuqi vendimin e APP-së dhe për dy të tjerat ka vendosur rrëzimin e vendimit të APP-së. Për këto dy çështje APP ka ankimuar vendimet e gjykatës së

shkallës së parë në Gjykatën e Apelit, dhe çështjet janë ende në proces.

### **6.2.3. Ndryshimi i legjislacionit**

Gjatë vitit 2009, është miratuar nga Kuvendi ligji nr. 10157 datë 15.10.2009, “Per disa ndryshime në ligjin nr.9663 datë 18.12.06 “Për koncesionet” i ndryshuar. Ky ligj parashikon krijimin e Agjencisë së Koncesioneve, e cila midis të tjerash do të ketë të gjitha kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik për shqyrtimin e ankesave në procedurat koncesionare. Me këto ndryshime legislative, APP nuk do të ketë, asnjë kompetencë në fushën e koncesioneve.

### **6.3. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË INSPEKTIMIT**

Agjencia e Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin Nr. 9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik” dhe VKM-në nr.1, dt.10.1.2007 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj, duke u kërkuar autoriteteve kontraktore të dorëzojnë të gjithë informacionin përkatës, si dhe kryen kontrole ne autoritetet kontraktore per procedurat që financohet nga Buxheti i Shtetit. Në rast shkeljesh të ligjit te siperpermendur dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, ka mbeshtetje ligjore te vendosë gjoba sipas nenit 72 të LPP-se ose t’i propozoje drejtuesit të autoritetit kontraktor apo organeve më të larta masa disiplinore për personat pergjegjes te autoriteteve kontraktore, që i kanë kryer këto shkelje. Gjithashtu shqyrton raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe auditeve te brendshme, pas kontrollit të procedurave të prokurimit, për rekomandimet që lidhen me vendosjen e gjobave, dhe mer vendim përfundimtar për vendosjen ose jo të

këtyre gobave. Këto detyra në Agjencinë e Prokurimit Publik kryhen nga Sektori i Inspektimit.

Ne kuader të verifikimit të zbatimit të procedurave në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit Sektori i Inspektimit ka bërë përpjekje maksimale për të dhënë ndihmesën e tij për realizimin e objektivave të vendosura. Në punën e tyre specialistët e sektorit të inspektimit kanë respektuar afatet e përpunimit të shkresave si dhe etiken profesionale në punë.

**6.3.1. Drejtimit kryesore në të cilat është përqendruar puna në Sektorin e Inspektimit gjatë vitit kalendarik 2009 kanë qenë:**

- Pjesëmarrja në grupet e punës për përgatitjen e propozimeve të ndryshme për legjislacionin e prokurimit publik;
- Pjesëmarrja si lektor në trajnime të ndryshme të organizuara nga ITAP dhe APP-ja, për ngritjen e kapaciteteve kualifikuese të punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore për ndryshimet në legjislacionin e prokurimeve, në vecanti për marrëveshjen kuadër dhe utilitetet;
- Pjesëmarrja në hartimin e dokumentave standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit, sipas rregullave të prokurimit publik, për karburantet (shkurt 2009);
- Në përputhje me detyrat që i ngarkon Titullari i APP-se, ka dhënë këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi, nëpërmjet shkresave zyrtare dhe komunikimit të drejtperdrejte;
- Bashkëpunim me autoritetet kontraktore në implementimin e përdorimit të standardeve të licensimit, në procedurat e prokurimit publik, kryesisht në dokumentat e tenderit për kontratat e punëve, duke

mbajtur lidhje të vazhdueshme me autoritetet perkatese qe miratojne standartet e licensimit.

- Kontrollimi i zbatimit te procedurave të prokurimit publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj.
- Marrja e masave administrative te gjobes ose masa disiplinore sipas nenit 72 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik”, ose propozim drejtuesit të autoritetit kontraktor apo organeve më të larta per marrjen e masave disiplinore për personat e autoriteteve kontraktore, që kanë kryer shkelje të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.
- Verifikon në sistemin elektronik të APP-së, rregullshmërinë e dokumentave te tenderit të publikuara nga autoritetet kontraktore.
- Pjesëmarrje ne procese gjyqesore ne lidhje me vendimet e dhena nga Agjencia e Prokurimit Publik per vendosje masash administrative, anulime procedurash si dhe perjashtimin e operatoreve nga procedurat e prokurimit publik.

### **6.3.2. Kontrolli i zbatimit te procedurave të prokurimit publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj.**

Kryerja e inspektimeve prane autoriteteve kontraktore si dhe në sistemin elektronik per procedurat e prokurimit ka qene nje detyre primare e specialisteve te ketij sektori. Ne total gjatë vitit 2009, jane kryer **8 inspektime** pranë Autoriteteve Kontraktore si dhe **26 inspektime në sistemin elektronik të APP-së**. Inspektimet janë kryer si rrjedhojë e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, palët e interesuara nëpërmjet telefonit, postës elektronike dhe asaj shkresore. Një pjesë e konsiderueshme e inspektimeve janë percjelle nga sektorët e tjerë si sektori i shqyrtimit të ankesave, sektori IT ne APP si dhe nga Drejtoria e Marredhënieve me Publikun pranë Kryeministrit.

Gjatë inspektimeve të procedurave të prokurimeve të

zhvilluara nga AK jane konstatuar shkelje kryesisht në argumentimin e fondit limit, në procesin e shqyrtimit të ofertave, në respektimin e afateve të ankimimit ashtu dhe ne perpilimin e dokumentacionit te tenderave nga autoritetet kontraktore. Gjithashtu, janë bërë verifikime ne sistemin e prokurimit elektronik përse i përket rregullshmërisë së Dokumenteve te Tenderit të shpallura nga Autoritetet Kontraktore ku është konstatuar se, në **30** raste kanë patur gabime ne datat dhe oraret e hapjes së ofertave.

Keto shkelje ngarkojne me pergjegjesi anetaret e njesive te prokurimit si dhe anetaret e komisioneve te vleresimit te ofertave te autoriteteve kontraktore. Per rrjedhoje ne perputhje me nenin 72 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik” iu eshte propozuar Titullareve te Autoriteteve Kontraktore që të marrin masa disiplinore për **13** procedura te prokurimit publik si dhe jane vendosur nga APP-ja, masa gjobe per **23** procedura prokurimi publik te kryera nga AK te ndyshme, ketu perfshihen titullare te AK-ve, anetare te njesise se prokurimit dhe anetare te komisioneve te vleresimit te ofertave.

Në **29** procedura prokurimi janë penalizuar personat përgjegjës me mase gjobe prej 50 mijë lekë dhe në 5 procedura prokurimi me gjobe ne vleren prej 100.000 leke (këtu përfshihen anëtarët e KVO-së, Njesisë së Prokurimit si dhe Titullarët e AK).

Pervec veprimtarise se mesiperme, nga ky Sektor, jane bere dhe shqyrtime administrative persa i perket kërkesave për rishikim të vendimeve të dhena nga APP-ja të paraqitura nga zyrtarë të ndryshem prokurimi si dhe nga operatorët ekonomikë, të cilat për vitin 2009 kanë qenë **22 kërkesa për revokim** vendimi.

Ne mbeshtetje te LPP-se, Agjencia e Prokurimit Publik ka kompetencë të shqyrtoje rekomandimet e dhëna nga auditet

## **Raporti Vjetor\_2009**

e brendshme të Institucioneve Qëndrore si dhe rekomandimet e dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe të dale me vendime perfundimtare duke dhënë masa administrative të propozuara nga keto audite në përputhje me shkeljet e konstatuara nga ana e tyre të pasqyruara në raportet përfundimtare.

Ne kete kuader nga sektori i inspektimit jane shqyrtuar **16 Raporte Kontrolli** të Auditeve të Brendshme të Ministrive dhe Prefekturave si dhe **24 Raporte Kontrolli të KLSH-së** per vitin 2009. Ne shqyrtimet e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga këto audite per masat administrative te propozuara nga këto organe dhe te miratuara nga APP-ja rezulton se ne shumicen e rasteve masat administrative ndaj personave pergjegjes që kanë kryer shkelje janë rekomanduar ne perputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Ne mbeshtetje te LPP-se, Sektori i Inspektimit ka mbeshtetur ne vendimmarrje Avokatin e Prokurimeve per trajtimin e ankesave apo dhenien e masave administrative ndaj personave pergjegjes **ne 9 raste.**

### **6.3.3. Pjesemarrja ne permiresimin e ligjislacionit paresor dhe dytesor per Prokurimin Publik**

Nje detyre kryesore e Agjencise se Prokurimit Publik per vitin 2009 ka qene permiresimi i legjislacionit te prokurimit publik. Edhe në këtë drejtim, Sektori i Inspektimit ka dhënë kontributin e tij. Gjithashtu pjesmarrja e specialisteve te ketij sektori ka qene aktive ne grupet e punës për hartimin e shtesave dhe ndryshimeve të rregullave te reja per prokurimin publik, ne përputhje me ndryshime ligjore në fuqi.

Per kete arsye eshte bashkepunuar ngushte me specialistet e sektoreve te tjere si dhe me ekspertet e huaj qe kanë asistuar APP ne kete drejtim. Nje rol aktiv specialistet e ketij sektori

kane dhene dhe ne pergatitjen e disa ndryshimeve në Dokumentat Standarde te Tenderave.

#### **6.3.4. Dhenia e ndihmes per kualifikimin e punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik si dhe ngritja e nivelit profesional te specialisteve te sektorit te kontrollit**

Per vitin 2009, nga ana e specialisteve te Sektorit te Inspektimit nje vemendje e madhe i eshte kushtuar dhenies se ndihmes ne per kualifikimin e punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik. Ky objektivi eshte arritur si ne dhenien e asistences per specialiste te rinj prane APP-se dhe ne perfshirje si trainerë ne trajnime te ndryshme të organizuara nga APP-ja ose institucione të tjera në bashkëpunim me APP-në.

Nje tjetër prioritet i punes se specialisteve te ketij sektori ka gene dhe ngritja e nivelit profesional ne punen e perditshme duke mare pjese ne trajnimet qe kane organizuar organizma të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

#### **6.3.5. Përfaqësimi i APP-së ne procese gjyqesore**

Sektori i Inspektimit, gjatë vitit 2009, ka ndjekur 39 çështje gjyqësore ne lidhje me vendimet e dhena nga Agjencia e Prokurimit Publik per vendosje masash administrative, anulime procedurash si dhe perjashtimin e operatoreve ekonomikë nga procedurat e prokurimit publik.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të rrethit Tiranë dhe të rretheve të tjera, kanë qenë në proces gjykimi 39 çështje civile, ku për 16 procese është dhënë vendimi i formës së prerë, ndërsa 23 çështje të tjera janë ende në proces gjykimi.

Nga vendimet e marra, 7 janë dhënë në favor të APP-së, ndërsa 9 të tjerat janë apeluar nga kjo e fundit

### **6.3.6. Bashkepunimi me sektoret e tjere te Agjencise se Prokurimit Publik**

Nje aspekt tjetër qe specialistet e sektorit te kontrollit kane pasur ne vemendje te tyre gjate vitit 2009 ka qene dhe bashkepunimi me sektoret e tjere te Agjencise se Prokurimit Publik. Si rrjedhoje e ketij bashkepunimi jane pergatitur materiale te ndryshme apo eshte bashkerenduar puna ne shqyrtime te dosjeve te ndryshme te procedurave te prokurimit.

### **6.4. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË BULETINIT DHE STATISTIKËS PËR VITIN 2009**

Një nga detyrat e Agjencisë së Prokurimit Publik është dhe botimi i Buletinit të Njoftimeve Publike. Gjatë vitit 2009, ky Buletin është botuar çdo të hënë dhe përpunimi i të dhënave dhe hartimi i tij është detyrë e Sektorit të Buletinit dhe Statistikës. Me legjislacionin e ri për prokurimin elektronik gjatë 2009, përveç publikimit të njoftimeve në Buletinin e Njoftimeve Publike, Sektori i Buletinit dhe Statistikës ka bërë dhe publikimin e të gjithë njoftimeve të kontratave, njoftimeve të fituesit si dhe njoftimeve të kontratës së nënshkruar që autoritet kontraktore kanë aplikuar në faqen e Ëeb-it të APP-së.

Gjatë këtij viti, Sektori i Buletinit dhe Statistikës ka bërë gjithashtu dhe publikimin e të gjithë njoftimeve të fituesit si dhe njoftimeve te kontratës së nënshkruar në faqen e Ëeb-it të APP-së, për procedura jo elektronike të shpallura gjatë vitit 2008 dhe të përfunduara gjatë vitit 2009.

Gjatë vitit 2009 Agjencia e Prokurimit Publik ka botuar **53** Buletine të Njoftimeve Publike që përbëjnë rreth **13. 618** faqe në total, ose mesatarisht **257** faqe për Buletin.



## Raporti Vjetor\_2009

Në Buletinin e Njoftimeve Publike janë botuar njoftime kontratash për procedurat e shpallura të prokurimit, njoftimet e fituesit, njoftimet e kontratave të nënshkruara, njoftimet e anulimit të procedurave të prokurimit, si dhe njoftime të tjera ku vendin kryesor e zënë njoftimet e administratës publike, si dhe njoftimet për ankand.

### 6.4.1. Statistika në lidhje me numrin e njoftimeve të procedurave të prokurimit publik të shpallura gjatë vitit 2009

- Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2009, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall dhe punë, në faqen zyrtare të APP-së është 7277, nga të cilët:

Njoftime kontratash për vitin 2009					
Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i procedurës	Numri i njoftimeve të kontratave	Lloji i procedurës	Numri i njoftimeve të kontratave	Lloji i procedurës	Numri i njoftimeve të kontratave
Shërbime konsulence dhe Konkurs projektimi	216				
Procedura negociim me shpallje paraprake	1	Procedura negociim me shpallje paraprake	5	Procedura negociim me shpallje paraprake	3
E hapur ndërkombëtare	3	E hapur ndërkombëtare	5	E hapur ndërkombëtare	3
Procedurë e hapur	447	Procedurë e hapur	1154	Procedurë e hapur	1599
Kërkesë për propozim	725	Kërkesë për propozim	1853	Kërkesë për propozim	1252
Procedurë e kufizuar	4	Procedurë e kufizuar	5		
		E kufizuar ndërkombëtare	2		
<b>Totali</b>	<b>1396</b>	<b>Totali</b>	<b>3024</b>	<b>Totali</b>	<b>2857</b>

**- Numri total i njoftimeve të fituesit të publikuara është 3615, nga të cilët:**

Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i procedurës	Numri i njoftimeve të fituesve	Lloji i procedurës	Numri i njoftimeve të fituesve	Lloji i procedurës	Numri i njoftimeve të fituesve
E hapur ndërkombëtare	1	E hapur ndërkombëtare	5	E hapur ndërkombëtare	1
Procedurë e hapur	150	Procedurë e hapur	607	Procedurë e hapur	944
Kërkesë për propozim	289	Kërkesë për propozim	785	Kërkesë për propozim	734
		Procedurë e kufizuar	2		
		E kufizuar ndërkombëtare	1		
				Procedura negociim me shpallje paraprake	1
Shërbime konsulence	95				
<b>Totali</b>	<b>535</b>	<b>Totali</b>	<b>1400</b>	<b>Totali</b>	<b>1680</b>

- Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkuara të publikuara është 3634 nga të cilët:

Njoftime kontratash të nënshkuara për vitin 2009					
Shërbime		Mallra		Punë	
Lloji i procedurës	Numri i njoftimeve të kontratave të nënshkuara	Lloji i procedurës	Numri i njoftimeve të kontratave të nënshkuara	Lloji i procedurës	Numri i njoftimeve të kontratave të nënshkuara
E hapur ndërkombëtare	1	E hapur ndërkombëtare	26		
Procedurë e hapur	150	Procedurë e hapur	607	Procedurë e hapur	944
Kërkesë për propozim	289	Kërkesë për propozim	785	Kërkesë për propozim	734
		E kufizuar ndërkombëtare	1		
Procedurë e kufizuar	1				
				Procedura negociim me shpallje paraprake	1
Shërbime konsulence	95				
<b>Totali</b>	<b>536</b>	<b>Totali</b>	<b>1419</b>	<b>Totali</b>	<b>1679</b>

Gjithashtu gjatë këtij viti janë publikuar dhe **1.182** Kontrata të nënshkuara për procedura me negociim pa publikim të njoftimit të kontratës.

Në mënyrë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik për vitin 2009, fondet limite përkatëse dhe kursimin në %, janë si më poshtë:

**Nr total i procedurave te shpallura te ndare sipas llojit te procedurave per Periudhen 3 Janar 2009 - 31 Dhjetor 2009**

Nr.Total i Proçedurave te shpallura	8459
Fondi total limit i proc.te shpallura	110,722,796,084
sherbim konsulence nr	216
sherbim konsulence ne vlere	2,185,956,022
negocim me shpallje nr	9
negocim me shpallje ne vlere	17357490
I hapur nderkombetar nr	11
i hapur nderkombetar ne vlere	12,904,892,615
I hapur lokal nr	3,200
I hapur lokal ne vlere	80,276,016,724
kerkese me propozim nr	3,830
kerkese me propozim vlere	9,125,111,004
I kufizuar nderkombetar nr	2
I kufizuar nderkombetar vlere	1,960,868,000
I kufizuar lokal nr	9
I kufizuar lokal vlere	497,672,013
negocim pa shpallje nr	1,182
negocim pa shpallje vlere	3,754,922,217

Procedura prokurimi te zhvilluara ne sistemin elektronik - Periudha 3 Janar 2009 - 31 Dhjetor 2009

Nr.Total i Proçedurave te shpallura	7277
Fondi total limit i proc.te shpallura	106,967,873,867
Nr.Total i Proçedurave te shpallura dhe ende ne proces	1034
Fondi total limit i proc.te shpallura dhe ende ne proces	21,169,037,580
Nr.Total i Proçedurave te shpallura te anuluar	2628
Fondi total limit i proc.te shpallura te anuluar	25,746,131,128
Nr.Total i Proç.te fituara	3615
Fondi total limit i prokuruar	60,052,705,159
Fondi total i ofruar	51,358,000,549
% qe ze Fondi i ofruar ndaj Fondil limit te prokuruar	85%
Fondi total i kursyer	8,694,704,610
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondil limit te prokuruar	15%

Prokurime elektronike dhe Proc me Negocim pa shpallje paraprake te njoftimit  
 te shpallura total dhe te perfunduara me lidhje kontrate total per Periudhen 3 Janar 2009 - 31 Dhjetor 2009

Nr.Total i Proçedurave te shpallura	8459
Fondi total limit i proc.te shpallura	110,722,796,084
Nr.Total i Proç.te fituara elektronik	3615
Fondi total limit i prokuruar per proced elektronike	60,052,705,159
Fondi total i ofruar per proced elektronike	51,358,000,549
Nr.Total i Proç.te fituara Negoc pa shpallje	1182
Fondi total limit i prokuruar negoc pa shpallje	3,754,922,217
Fondi total i ofruar negoc pa shpallje	3,522,045,649
% qe ze nr l proc te fituara negoc me shpallje ndaj nr total te procedurave te perfunduara me lidhje kontrate	24.6%
% qe ze fondi limit l proced me negoc pa shpallje ndaj fondit limit per procedurat e perfunduara me lidhje kontrate	5.9%
% qe ze fondi l ofruar proced me negoc pa shpallje ndaj fondit total te ofruar ne procedurat e perfunduara me lidhje kontrate	6.4%
Nr.Total i Proç.te fituara (elektronik + negociim pa shpallje)	4797
Fondi total limit i prokuruar (elektronik + negociim pa shpallje)	63,807,627,376
Fondi total i ofruar (elektronik + negociim pa shpallje)	54,880,046,198
% qe ze Fondi i ofruar ndaj Fondil limit te prokuruar	86%
Fondi total i kursyer	8,927,581,178
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondil limit te prokuruar	14%

Të dhëna për procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2009

Llojet e procedurave	Nr. Total i procedurave	Fondi limit total i prokuruar	Fondi limit total i ofruar (tenderuar)	% e fondit limit të fituar me fondin limit të prokuruar	Fondi Total i kursyer	% e fondit limit të kursyer me fondin limit të prokuruar
Totali	3615	60,052,705,159	51,358,000,549	85.00%	8,694,704,610	15.00%
Procedura të hapura (kombëtare+nderkombëtare) (njoftim fituesi)	1708	54,593,844,173	46,403,638,462	85.00%	8,190,205,711	15.00%
Kërkesë për propozim (njoftim fituesi)	1808	4,603,835,484	4,119,891,168	89.49%	483,944,316	10.51%
Procedura të kufizuara (kombëtare) (njoftim fituesi)	3	56,436,433	55,832,600	99.00%	603,833	1.00%
Negociim me njoftim paraprak (njoftim fituesi)	1	4,166,660	4,101,152	98.43%	65,508	1.57%
Sherbim Konsulence (njoftim fituesi)	95	794,422,409	774,537,167	97.00%	19,885,242	3.00%

Si është përmendur dhe më sipër këto procedura janë zhvilluar në mënyrë elektronike nga të gjithë autoritetet kontraktore Pas publikimit, nga autoritetet kontraktore është bërë hedhja në Buletin i njoftimeve të ndryshme si dhe miratimi i tyre nga zyrtari i prokurimit që është pjesë e sektorit të sipërpërmendur në APP.


Në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe paralelisht në faqen zyrtare të APP-së, janë publikuar periodikisht dhe firmat e përjashtuara nga procedurat e prokurimit publik si dhe ato që kanë qënë në proces përjashtimi.

## 6.5. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT


Gjatë vitit 2009, APP ka bërë përmirësime të ndjeshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Sistemin e Prokurimeve Publike të Shqipërisë. Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme të APP-së dhe suporti i “user-ave” ka qënë një nga detyrat e përditshme të sektorit të IT. Gjithashtu një përmirësim të dukshëm ka patur edhe në faqen e internetit të APP-së, e cila u ristrukturua dhe u pasurua me informacion në lidhje me procesin e prokurimit. Gjatë vitit 2009 u bë i mundur dhe kryerja e të gjithë procedurave të tenderit, edhe ato me lote me prokurim elektronik, në faqen e internetit të APP-së. Kjo ishte një arritje shumë e rëndësishme në aspektin e transparencës, lehtësisë së gjetjes së të dhënave dhe efikasitetit në procesin e prokurimit publik.

### 6.5.1. Paraqitja grafike e procedurave të prokurimit publik dhe numrit të ofertave dhe ofertuesve:


Në diagramat e mëposhtme pasqyrohen procedurat e publikuara në faqen e APP-së, gjatë vitit 2009, krahasuar me vitin 2008:









Në diagramat e mëposhtme pasqyrohen njoftimet e fituesit të publikuar në faqen e APP-së, gjatë vitit 2009 krahasuar me vitin 2008:



Numri i ofertave në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë vitit 2009 te krahasuara me vitin 2008 si dhe mesatarja e ofertave per procedura, paraqitet si më poshtë:



### **6.5.2. Përmirësimet e bëra në sistemin e prokurimit elektronik si dhe hyrja në sistem nga të interesuarit**

Gjatë vitit 2009 nga Sektori i IT-së janë bërë përmirësime mbi sistemin e prokurimit. Këto ndërhyrje janë bërë si për pjesën që i përket operatoreve ekonomik dhe ne panelin që aksesohet nga rolet e njesive të prokurimit, komisionit të vlerësimit të ofertave, audituesve etj.

Gjithashtu një detyrë e rëndësishme e këtij Sektori gjatë vitit 2009 ka qënë hedhja në një bazë të dhënash e të gjitha procedurave duke bërë kështu procesin në sistem një proces më koherent dhe më të sigurt. Po kështu monitorimi i vazhdueshëm i komunikimit me databazën e QKR-së ka sjelle një kontroll më të madh mbi operatorët ekonomikë.

Gjatë këtij viti Sektori i IT ka punuar intensivisht për përmirësimin e disa funksioneve në sistem dhe konkretisht janë bërë këto ndryshime kryesore:

- Mundësimi i realizimit të procedurave të prokurimit publik me lote, në sistem në të njëjtën mënyrë sikurse zhvillohen dhe procedurat normale të prokurimit;
- Mundësimi i kryerjes së rivlerësimit të procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike në sistem, ashtu sikurse bëhet dhe vlerësimi fillestar i këtyre procedurave;
- Krijimi i rolit të audituesve të çdo niveli në sistem, për procedurat e prokurimit publik të kryera në formë elektronike;
- Kalimi i të drejtës së administrimit (krijimin e roleve në sistem), nga APP-ja tek Autoritetet Kontraktore.

Për vitin 2009 nga sektori i IT janë krijuar më shumë se 10151 persona me llogari përdoruesi dhe janë krijuar më shumë se 1900 llogari përdoruesi për autoritetet kontraktore në sistem.

Numri i përdoruesve te sistemit të prokurimit elektronik në vitin 2009 është si më poshtë:

Hits-et ne Total:	192289252
Mesatare e Hits-eve Per Dite:	5272291
Mesatare Hits-eve Per Perdorues:	28271
Perdoruesit ne Total:	199958
Mesatare Perdoruesve Per Dite:	8995
Sesion-et ne Total:	856145
Mesatare e Sessioneve Per Dite:	21283
Mesatare e Sessioneve Per Perdorues:	821
Koha Totale e Shpenzuar ne Sitin e Internetit:	12228 ditë 15:02:14
Koha Mesatare e Shpenzuar Per Perdorues:	81 ditë 07:10:01
Koha Mesatare e Shpenzuar Per Sesionet:	41 ditë 04:04:00
Vizitoret ne Total:	286008
Mesatare e Vizitoreve per dite:	8520

Rritja e kapaciteteve ka qene nje nga sfidat e radhës të këtij Sektori. Tashme jemi nje sistem i cili e ka kaluar 1.6 TB databazë te dhenash si dhe nje aplikacion i cili shperndan ngarkesen ne 3 servera te ndryshem. Kujdesi per bazen e te

dhenave ka qene nje nga detyrat e perditeshme me te cilen eshte perballuar Sektorit i Teknologjisë së Informacionit.

### **6.5.3. Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP-së**

Nuk duhet harruar pa u përmendur edhe puna e përditshme e sektorit të IT në suportin e vetë përdoruesve brenda APP –së si dhe në menaxhimin e infrastrukturës. Kryerja e detyrave të ngarkuara dhe bashkëpunimi me sektorët e tjerë ka sjellë rezultate shumë të mira. Ketu vlen te permendet bashkëpunimi i Sektorit te IT me sektorin e Buletinit dhe Statistikave për evidentimin e rasteve problematike dhe zgjidhjen e tyre. Bashkëpunimi i ngushtë me Sektorin e Trajnimeve ka qënë jo pak rezultativ në trajnimin e gjithë anëtarëve të njësive të prokurimit dhe anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave për përdorimin e sistemit. Vlen te permendet dhe bashkëpunimi me Sektorin e Inspektimit dhe Drejtorine e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për prokurimet ku sektori i IT ka bere monitorim dhe kthim pergjigje për me shume se 150 raste. Bashkëpunimi me këtë Drejtori, ka qënë gjithashtu shumë produktiv në evidentimin dhe permirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.

Vënia në zbatim e sistemit të prokurimit elektronik në masën 100% ishte një nga prioritetet dhe njëkohësisht sfidat e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit për vitin 2009. Per vitin 2010 prioritetet e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit jane:

- Optimizimi i procesit te punes.
- Rritja e metejshme e sigurisë se Sistemit te Prokurimit Elektronik.
- Krijimi i Arkives Elektronike.
- Lehtesimi i databazes.
- Optimizimi i dokumentacionit qe perdoret per Sistemin e Prokurimit Elektronik .

- Trajnimi i perdoruesve te Sistemit te Prokurimit Elektronik.

## **6.6. TREGUESIT E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË TRAJNIMEVE, FINANCËS, INTEGRIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

Duke pasur parasysh:

- Rëndësinë që kanë marrëdhëniet me publikun, sidomos për prokurimet publike në kuadër të transparencës;
- Rëndësinë e madhe që kanë marrë trajnimet për prokurimet publike, në ligjin e prokurimit publik, sipas të cilit APP është institucioni përgjegjës për organizimin e seminareve dhe trajnimeve në fushën e prokurimit;
- si dhe detyrimin e përafritit të legjislacionit me Direktivat e BE-së dhe zgjidhjen dhe mbulimin e problemeve që dalin në kuadrin e integritit evropian,

edhe sektori i Trajnimeve, Financës, Integritit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në aktivitetin e APP-së gjatë vitit 2009.

### **6.6.1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore**

Gjatë vitit 2009 Sektori i Trajnimeve, Financës, Integritit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ka punuar për kryerjen e procedurave për realizimin e disa konkurseve për pranimin e nëpunësve civilë, në përputhje me legjislacionin për “Statusin e nëpunësit civil”.

Konkretisht, Sektori i Trajnimeve, Financës, Integritit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka kryer konkursin për 1(një) vend të lirë pune në muajin shkurt 2009 dhe 3 (tre) konkurse për 3 vende të lira pune gjatë muajve Qershor-Shtator. Emërimet e mësipërme konsistojnë në fitimin për herë të parë të statusit të nëpunësit civil, në përputhje me legjislacionin “Për statusin e nëpunësit civil”.

Gjithashtu gjatë këtij viti, ky sektor ka punuar për rifreskimin e të dhënave në regjistrin themeltar të punonjësve dhe janë riparë dhe plotësuar dosjet e çdo punonjësi të APP-së.

Autoriteti Përgjegjës në institucion edhe gjatë vitit 2009 ka mbajtur kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, ku ka raportuar emrat e personave përgjegjës për deklarimin e pasurive si dhe ka dërguar në kohë Deklarimet përkatëse.

Gjithashtu në muajin Shkurt të vitit 2009, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe i Kontrollit të Pasurive dhe Agjencia e Prokurimit Publik, përmes Autoritetit Përgjegjës, kanë pasur një bashkëpunim shumë të frytshëm dhe profesional, si rezultat i të cilit u hartua dhe u përfshi në setin e Dokumentave Standartë të Tenderit, “Deklarata e Konfliktit të Interesave të operatorëve ekonomikë që do të marrin pjesë në një procedurë prokurimi”. Kjo deklaratë u hartua në përputhje me legjislacionet e prokurimit publik dhe atë të parandalimit të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe është një mjet shumë i rëndësishëm në parandalimin dhe/ose identifikimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Një iniciativë tjetër shumë e rëndësishme gjatë vitit 2009 ka qënë dhe hartimi i Manualit të Konfliktit të Interesave në Prokurimin Publik, në të cilin ka dhënë kontribut dhe Agjencia e Prokurimit Publik, përmes Autoritetit Përgjegjës, i cili ishte anëtar i grupit të punës së ngritur për këtë qëllim. Ky manual i përgatitur dhe i publikuar gjatë vitit 2009 është një mjet shumë i rëndësishëm dhe ndihmës në parandalimin e konfliktit të interesave gjatë procedurave të prokurimit publik.

Gjithashtu gjatë vitit 2009, Autoriteti Përgjegjës i APP-së ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme informuese dhe trajnuese të organizuara nga ILDKP.

### **6.6.2. Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP-së dhe specialistëve të prokurimit pranë autoriteteve kontraktore**

- **Trajnimet e stafit të APP-së**

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve administrative, gjatë vitit 2009 përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik kanë marrë gjithashtu pjesë në një sërë seminaresh të organizuar brenda dhe jashtë vendit dhe konkretisht si më poshtë:

Gjatë periudhës Mars-Maj 2009, bazuar në kërkesat individuale të punonjësve të APP-së, për pjesëmarrje në trajnime, sektori ynë në bashkëpunim me ITAP, mundësoi trajnimin e 13 punonjësve të APP. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte rritja e kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre si nëpunës civilë (2 nga punonjësit e mësipërm ishin në periudhë provë).

Në muajin Maj 2009, përfaqësues nga APP-ja morën pjesë në Konferencën Rajonale 'Mbi sistemin e rishikimit sipas Direktivës së BE-së'. Në këtë konferencë merrnin pjesë përfaqësues nga të gjitha vendet e Ballkanit. Pasur parasysh tematikën dhe pjesëmarrjen, Konferenca shërbeu jo vetëm për prezantimin e sistemit të rishikimit në prokurime, sic parashikohet në prokurime, por gjithashtu dhe për shkëmbimin e eksperiencave me homologët e vendeve të rajonit, në këtë drejtim. Shkëmbimi i eksperiencave me vendet e rajonit është shumë i rëndësishëm, pasi të gjitha këto vende, përfshi këtu dhe Shqipërinë kanë të njëjtën problematikë në fushën e prokurimeve.

Në muajin Shtator, një përfaqësues i Agjencisë së Prokurimit Publik mori pjesë në ëorkshopin e organizuar nga Organizata Botërore e Tregtisë, në Vienë, Austri në kuadër të Marrëveshjes së OBT-së për Prokurimin Publik dhe Tekstit të Rishikuar të saj.



## **Raporti Vjetor\_2009**

Në muajin Dhjetor 2009, një përfaqësues i Agjencisë së Prokurimit Publik, mori pjesë në një Konferencë të organizuar nga SIGMA në bashkëpunimin me Agjencinë e Partneritetit Kroat, në Zagreb, Kroaci. Ëorkshopi kishte në fokus çështjet e koncesioneve dhe të partneritetit publik dhe privat.

- **Trajnimet e punonjësve të prokurimit pranë autoriteteve kontraktore**

Një rol shumë të rëndësishëm gjatë vitit 2009, APP-ja ka luajtur dhe në fushën e trajnimeve, dhe konkretisht në identifikimin e nevojave për trajnim, hartimin e planeve për trajnim si dhe organizimin dhe drejtimin e këtyre trajnimeve me punonjës prokurimi në të gjitha Autoritetet Kontraktore. Në kryerjen e kësaj detyre, Sektori në fjalë është mbështetur nga:

- a) Buxheti i shtetit ( nëpërmjet alokimit për herë të parë, në buxhetin e APP-së, të një fondi për trajnimet), për trajnime në periudhat Janar 2009 dhe Tetor-Dhjetor 2009;
- b) Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, për trajnime në periudhën Janar –Mars 2009;

- **Trajnime të realizuara me mbështetjen e ITAP-it**

Gjatë tre muajve të parë të vitit 2009, Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, realizoi 29 trajnime një ditore me punonjës të prokurimeve publike të administratës publike në nivel kombëtar. Në këto trajnime morën pjesë 868 punonjës prokurimi të cilët përfaqësojnë 739 autoritete kontraktore (Ministritë dhe institucione në varësi të ministrave dhe ministrive, Institucione Qëndore, SH.A. etj). Qëllimi kryesor i këtyre seminareve ka qënë njohja e pjesëmarrësve me legjislacionin e prokurimit si dhe me sistemin e prokurimit elektronik.

- **Trajnime të realizuara nga vetë stafi i APP-së**

## Raporti Vjetor\_2009

Në vitin 2009, sektori i trajnimeve zhvilloi respektivisht **54 seminare** një-ditore. 5 trajnime janë realizuar në fillim të vitit 2009 dhe 49 trajnime në periudhën Tetor-Dhjetor 2009. Qëllimi i seminareve ka qenë njohja me risitë në legjislacionin e prokurimit publik si dhe risitë në prokurimin elektronik.

Pjesmarrës në këto trajnime ishin titullarë dhe punonjës të prokurimit publik të autoriteteve kontraktore (administratës publike dhe pushtetit vendor). Në total morën pjesë 1053 përfaqësues nga të cilët 22% ishin titullarë të AK dhe 78% ishin punonjës të prokurimit.

### Tabelë përmbledhëse e trajnimeve

<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasi viti 2009</b>	<b>Raporti me 2008</b>
Trajnime	Numër	83	Rritur me 9% (1.092)
Pjesmarrës	Numër	2079	Rritur me 43% ( 1.429)
Autoritete Kontraktore	Numër	1357 (217njësi vendore)	Rritur me96.6% (1.966)

### Të tjera:

Duke bërë krahasimin me vitin 2008 rezulton një rritje e dukshme e aktivitetit të APP në lidhje me trajnimet. Në tabelën e mësipërme paraqiten në % rritjet e realizuara, parë në këndvështrimin sasior. Një rritje e tillë treguesish argumentohet me faktin se APP-ja për herë të parë ka pasur burimet e veta financiare (nga buxheti i shtetit), pasi vitin e kaluar financimi i trajnimeve u realizua në masën 96% vetëm nga donatorë të tjerë ITAP etj. Rritja e burimeve të financimit, ekspserienca e fituar e sektorit, sistemi i të dhënave të grumbulluara që nga vitit 2007 solli një orientim më të drejtë të trajnimeve, në një orientim më të drejtë në përcaktimin e kriterëve të pjesmarrjes në trajnime,

## **Raporti Vjetor\_2009**

përfshirjen në trajnime të një numri sa më të madh AK, duke mos rënë në përsëritje.

Nëse bëjmë një analizë cilësore të të dhënave të mësipërme rezulton se:

1-Gjatë vitit 2009, tematikat e tranimeve kanë qenë më të shumta në numër dhe më të larmishme. Gjatë vitit 2009 u synua rritja e kapaciteteve të punonjësve të prokurimit publik nëpërmjet njohjes së tyre me risitë në legjilacionin e prokurimit publik dhe risitë në sistemin e prokurimit elektronik.

2-Gjatë vitit 2009 krahas punonjësve të prokurimit publik, APP në trajnimet e realizuara përfshiu për herë të parë edhe titullarët e autoriteteve kontraktore, duke i ftuar ato drejtpëdrejtë në trajnimet që zhvilloi dhe përgatitur për to një modul të veçantë, atë të administratorit të sistemit.

3-Në trajnimet e realizuara nga vetë APP, u përdor sistemi i vlerësimit të cilësisë së trajnimit nga pjesmarrësit. Nga përpunimi i tyre rezultoi se pjesmarrësit vlerësuan pozitivisht trajnimet e realizuara nga APP dhe kërkuan që trajnime të tilla të jenë më të shpeshta dhe periodike. Të dhënat e marra nga fletë vlerësimit do të shërbejnë si një database për planifikimin dhe realizimin e trajnimeve në të ardhmen.

### **• Bashkëpunimi ndërinstytucional**

Në realizimin e objektivave për vitin 2009, në lidhje me trajnimet, APP ka bashkëpunuar ngushtë edhe me institucione të tjera si Ministrinë, Institucione të tjera Qëndrore të cilat në kuadër të bashkëpunimit institucional kanë mbështetur dhe ndihmuar APP në realizimin e trajnimeve. Mbështetja e tyre ka konsistuar në ofrimin e ambjenteve për realizimin e trajnimeve si dhe njoftimin e punonjësve të autoriteteve kontraktore të varësisë për të marrë pjesë në trajnime.

### **6.6.3. Integrimi**

Krahas detyrave të tjera, ky sektor është i ngarkuar edhe me përmbushjen e angazhimeve të institucionit, në kuadër të procesit të integrimit evropian. Konkretisht, gjatë këtij viti janë përgatitur në mënyrë të vazhdueshme raporte mbi progresin e arritur në fushën e prokurimit publik, në përputhje me detyrimet e marra me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Raportet e progresit, të cilat paraqiten pranë Ministrisë së Integritimit, hartohen në kuadër të iniciativave ligjore dhe forcimit të kapaciteteve administrative, të ndërmarra me qëllim përafrimin e legjislacionit të prokurimit publik me Direktivat e BE-së në këtë fushë, si dhe zbatimin e drejtë të tij.

Në këtë drejtim, në muajin Prill u zhvillua në Bruksel takimi i Grupit të Punës BE-Shqipëri, për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, në të cilin mori pjesë një përfaqësues i Agjencisë së Prokurimit Publik. Gjatë këtij takimi u bë një prezantim i progresit të arritur në fushën e prokurimit publik, si dhe u diskutua mbi draft amendimet më të fundit të legjislacionit të prokurimit publik, zbatimin e prokurimit elektronik, si dhe mbi masat e marra me qëllim lehtësimin e punës së autoriteteve kontraktore në këtë drejtim.

Gjatë këtij viti, në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, u hartuan dhe u miratuan nga Kuvendi i Republikës disa amendime, të cilat rregullojnë sistemin e rishikimit të ankesave të operatorëve ekonomikë, në lidhje me procedurat e prokurimit publik. Njëkohësisht, këto amendime rregullojnë dhe prokurimin publik në sektorët utilitarë. Duke qënë se këto amendime u përgatitën në dritën e direktivave korresponduese të Bashkimit Evropian, përpara se të kalonin për miratim në Këshillin e Ministrave e më pas në Kuvend, nga ky sektor u përgatit tabela e përputhshmërisë, e cila konsiston në përcaktimin e përjasjes së secilit draft nen me parashikimet e direktivave respektive.

Ndërkohë, në kuadër të programit IPA 2008, Agjencia e Prokurimit Publik është përfituese e një projekti binjakëzimi “Mbështetje për fuqizimin e sistemeve të prokurimit publik, konçesioneve dhe ankandit publik, në Shqipëri”. Me qëllim përzgjedhjen e një prej propozimeve të binjakëzimit të paraqitur për projektin në fjalë, në muajin Tetor 2009, 2 punonjës të Sektorit të Trajnimeve, Financës, Integritit & Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, morën pjesë në sesionet e prezantimit dhe të intervistave, të zhvilluar pranë Delegacionit të Komisionit Evropian, në Tiranë. Gjatë prezantimit të propozimeve për projektin e binjakëzimit nga shtetet anëtare respektive të Bashkimit Evropian, pjesëmarrësit nga Agjencia e Prokurimit Publik, patën mundësinë për të bërë pyetje dhe diskutuar mbi pritshmëritë e këtyre propozimeve. Në përfundim të këtij procesi, APP-ja përzgjodhi fituesin e projektit dhe vijoi punën në bashkëpunim dhe me Delegacionin e Komisionit Evropian për finalizimin e procesit dhe përgatitjen e kontratës me fituesin e projektit në fjalë.

Gjithashtu gjatë muajve Shtator-Dhjetor 2009, në kuadër të procesit të integritit, një rol të rëndësishëm ky sektor ka kryer dhe për plotësimin në kohë dhe me cilësi të Pyetësorit të Komisionit Evropian, për Shqipërinë, në lidhje me pyetjet që i përkasin fushës së prokurimit publik. Për këtë qëllim njësia e integritit pranë këtij sektori ka marrë pjesë intensivisht në të gjitha trainimet dhe takimet e zhvilluara nga Ministria e Integritit.

#### **6.6.4. Gjëndja financiare e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2009**

Agjencia Prokurimit Publik në zbatim të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2009”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, gjatë vitit 2009 ka marrë

fonde nga buxheti i shtetit, si dhe ka krijuar të ardhura dytësore, nga shitja e Buletinit të Njoftimeve Publike, si më poshtë:

Në 000/lekë

N r	Emërtimi	Plani Fillestar	Ndyshimet	Plani Përfund.	Fakti	%
1	Të ardhurat nga buxheti	165.607	-21.907	143.700	123.444	85.9
2	Të ardhura dytësore				7.986	-
	<b>Totali</b>				<b>131.430</b>	

Në buxhetin e miratuar për vitin 2009, APP-së i janë parashikuar në zërin 602 “Mallra e shërbime”, 35.000 mijë lekë, ndërsa sipas kërkesës sonë, me VKM nr. 250, datë 12.03.2009 i janë shtuar fonde në shumën 7.000 mijë për rritjen e kapacitetit të shërbimit të internetit.

Shpenzimet e përgjithshme të APP-së, në fund të muajit dhjetor 2009, kanë arritur në rreth 123.4 mijë lekë, nga rreth 165.6 mijë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 74.5 përqind, ose me ndryshimet e bëra me planin përfundimtar, 85.9 përqind, me nje mosrealizim prej rreth 20.256 mijë lekë. Krahasuar me planin vjetor të realizuar, të së njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 76 mijë lekë më shumë ose rreth 158 përqind më të larta.

Në totalin e shpenzimeve buxhetore të realizuara, gjatë vitit 2009, shpenzimet korente zenë rreth 48 përqind, nga rreth 51.5 përqind të parashikuara, ndërkohë që shpenzimet për investime zenë rreth 52 përqind nga 48.5 përqind të parashikuara.

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve korente, situata e realizimit të tyre në fund të vitit 2009, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

	Emërtimi	Plan 2009	Fakt 2009	Ne %
1	Shpenzime paga	26.875	25.816	96
2	Sigurime Shoqërore	5.000	4.531	90.6
3	Mallra Shërbime	42.110	28.881	68.6
4	Transferta F.veçantë	15	15	100
5	Shpenzime për investime	69.700	64.201	92
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>143.700</b>	<b>123.444</b>	<b>85.9</b>

Brenda shpenzimeve korente, shpenzimet e personelit, që përfaqesojnë rreth 51 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë vitit 2009, rezultojnë me një mosrealizim prej rreth 1.528 mijë lekë, ose realizuar me rreth 95.2 përqind me parashikimin vjetor. Shpenzimet e planifikuara për shpërblime nga fondi i veçantë për vitin 2009, nuk u realizuan, nga ndalimi i dhënies së shpërblimeve pas datës 14 dhjetor 2009.

Shpenzimet operative që përfaqësojnë rreth 48.8 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë këtij viti, rezultojnë me një kursim prej rreth 13.229 mijë lekë.

Ndër zërat kryesorë janë:

- shpenzimet për prodhimin e Buletinit të Njoftimeve Publike për vitin 2009 arritën në vlerën 10.884 mijë lekë, nga këto të likuiduara 10.156 mijë lekë dhe diferenca prej 728 mijë lekë që i përkiste faturave të fund vitit nuk u kaluan nga Dega Thesarit. Krahasuar me vitin 2008 që u realizua për 12.300 mijë lekë, parashikimi për vitin 2009 ishte për 13.789 mijë lekë, por këtë vit numri i abonentëve pati rënje, nga 1400 abonentë në vitin 2008 arriti mesatarisht në 1100 abonentë për vitin 2009.

-Shpenzimet për shërbim interneti –nga fondi i parashikuar në fillim të vitit, me realizimin e procedurave të prokurimit u kursyen rreth 6.638 mijë lekë.

Gjithashtu në këtë mospërdorim të fondit të shpenzimeve operative ka ndikuar dhe mos likuidimi i disa pagesave për shpenzimet e kryera në fund të vitit 2009 në vlerën 2.054 mijë lekë, të cilat u anuluan nga Dega e Thesarit për të gjitha institucionet.

Shpenzimet kapitale, janë realizuar 92 përqind. Fondi i planifikuar në fillim të vitit ishte 98.607 mijë lekë, në të cilën ishte edhe fondi për rikonstruksionin e zyrave të APP-së tek ish INIMA. Meqenëse zhvendosja e zyrave u anulua, fondi për 28.907 mijë lekë, sipas kërkesës sonë me buxhetin e rishikuar të vitit 2009 u paksua nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit.

Të ardhurat e krijuara nga Posta Shqiptare për abonimin dhe shpërndarjen e buletinit derdhen 100% në buxhetin e shtetit dhe nuk ka detyrime të prapambetura nga vitet e kaluara. Detyrimet ndaj të tretëve janë shlyer rregullisht. Deri tani janë likujduar të gjitha faturat ndaj tyre dhe në vazhdimësi likujdohen faturat e prodhimit të buletinit të prokurimit publik.

Nga auditimi i ushtruar nga KLSH për periudhën 01.01.2007 deri në datën 31.08.2009, u konstatua se veprimet kontabël janë kryer konform dispozitave ligjore në fuqi dhe janë zbatuar parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Nga auditimi i gjëndjes së llogarive rezultoi se evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave.

## **7. MARRËDHËNIET E APP-SË ME TË TRETËT**

Gjatë vitit 2009, përveç komunikimeve shkresore, nëpunësit e APP-së, u kanë dhënë shpjegime dhe këshilla përfaqësuesve të institucioneve dhe në takime të zhvilluara në ambjentet e APP-së. Gjatë këtij viti nëpunësit e APP-së kanë pritur në takime 2292 përfaqësues të Autoriteteve Kontraktore dhe Operatorëve



Ekonomikë. Konkretisht numri i AK-ve që kanë kërkuar takim në APP gjatë këtij viti ka qënë 2248 ndërsa numri i operatorëve ekonomikë ka qënë 44. Këto takime janë zhvilluar me Drejtori dhe Sektorë të ndryshëm të APP-së, nga të cilët numrin më të madh e zënë Sektori i Buletinit dhe Statistikës me 789 takime, i ndjekur nga Sektori i IT me 737 takime, Drejtorja e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Prokurimet me 592 takime, Sektori i Trajnimit dhe Integritimit me 95 takime, Drejtorja e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Koncesionet me 44 takime dhe Sektori i Inspektimit me 33 takime.

## **8. PËRMBYLLJE**

Nga të dhënat e çdo drejtorie dhe sektori vihet re një rritje e konsiderueshme e ngarkesës dhe njëkohësisht e rezultateve të punës së Agjencisë së Prokurimit Publik. Kjo është e pasqyruar qartë në rezultatet e arritura në fund të vitit 2009, dhe konkretisht në projektet legislative të iniciuara dhe të përgatitura nga APP-ja, në numrin e procedurave të prokurimit të publikuara në Buletinin e Njoftimeve Publike, në numrin e ankesave të shqyrtuara, numrin e inspektimeve të kryera si dhe numrin e trajnimeve të realizuara në fushën e prokurimit publik. Gjithashtu për herë të parë në vitin 2009 është aplikuar prokurimi publik me mjete elektronike në masën 100%, për të gjitha Autoritetet Kontraktore dhe për të gjitha llojet e procedurave të prokurimit publik. Në këtë kuadër gjatë këtij viti, APP-ja është përballuar me një sfidë shumë të madhe, në ngritjen dhe administrimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme për aplikimin e një sistemi të tillë nga Autoritetet Kontraktore. Për shkak të aplikimit për herë të parë të këtij sistemi si dhe ndryshimeve legislative të bëra gjatë këtij viti, ngritja e kapaciteteve të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit, mori një rëndësi shumë të madhe. Nga rezultatet e raportuara më sipër, duket qartë se kontributi që APP-ja ka dhënë në këtë drejtim ka qënë shumë i madh dhe njëkohësisht shumë i vlefshëm, për funksionimin e sistemit të prokurimit publik.

Përpjekjet e APP-së për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, janë vlerësuar gjithashtu dhe nga Progres Raporti për Shqipërinë për vitin 2009 i Komisionit Evropian. Ky Raport ka vlerësuar progresin e bërë në fushën e prokurimit publik. Në mënyrë të veçantë Raporti ka vlerësuar rritjen e transparencës dhe uljen e kostove në procedurat e prokurimit, gjë që është arritur nëpërmjet zbatimit të sistemi të prokurimit elektronik. Gjithashtu në këtë raport vlerësohet dhe kontributi që APP-ja ka dhënë në asistimin e Autoriteteve Kontraktore për realizimin e procedurave të prokurimit dhe në ngritjen e kapaciteteve si të stafit të APP-së, ashtu dhe të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në Autoritete Kontraktore.

Raporti ka evidentuar nevojën e përafrimit të legjislacionit të prokurimit publik me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian në drejtim të sistemit të rishikimit dhe prokurimit në sektoret utilitarë. Edhe ky rekomandim i Komisionit Evropian u përmbush në fund të vitit 2009, me ndryshimet legjislative të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, siç është përmendur dhe në fillim të kësaj analize.

Megjithatë, ky Raport thekson se megjithë arritjet, është ende e nevojshme marrja e masave për shmangien e korrupsionit në prokurimet publike, si dhe ngritja e kapaciteteve administrative për një implementim sa më të mirë të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi dhe të legjislacionit të prokurimit publik në veçanti.

Megjithë progresin dhe arritjet e bëra gjatë vitit 2009, për realizimin e detyrave dhe përmbushjen e mëtejshme të angazhimeve të ndërmarra në fushën e prokurimit publik, APP - ja ka akoma një sërë prioritesh, për të cilat duhet të punojë në vazhdim. Ndër to si më kryesoret theksojmë,

- mirë implementimin e legjislacionit të prokurimeve, sidomos në drejtim të prokurimeve në sektorët utilitarë

- dhe në ngritjen e një sistemi rishikimi të pavarur, dy sektorë të rinj në fushën e prokurimit;
- zbatimin në masën 100% dhe përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik;
  - Forcimi i kapaciteteve administrative të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit, e cila është një sfidë që ngelet gjithmonë e hapur, duke qënë se legjislacioni i prokurimit është në proces të vazhdueshëm ndryshimi. Ngritja e kapaciteteve administrative është një sfidë shumë e rëndësishme me të cilën APP-ja do të përballohet gjatë vitit 2010, duke pasur parasysh që gjatë këtij viti për herë të parë do të aplikohen rregulla të posaçme për prokurimin në sektorët utilitarë si dhe aplikimi i marrëveshjes kuadër, koncepte këto të reja jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vendet e rajonit dhe në disa raste (marrëveshjet kuadër) dhe për ato të BE-së.